



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 24.12.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 20.12.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Bashkimi" për aktivitetin: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-7086-211 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "**Bashkimi**" e datës 20.12.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale ", me nr.616 18 7086 211 dhe nr. Brendshëm 616 18 116 211 kundër *Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës të AK –së*, të datës 19.12.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

1. Vërtetohet *Njoftimi i Vendimit për dhënje të kontratës* i publikuar me datë: 19.12.2018;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Bashkimi**" me datë 20.12.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve rurale" me Nr.616 18 7086 dhe Nr. Brendshëm 616 18 116 211".

Autoriteti Kontraktues, me datë 24.12.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:


1. Pretendimet për shkeljen e nenit 72 nuk janë të bazuara, pasi që si që e keni shënuar edhe vete në kërkesën tuaj Ak-ja mund të ftoj OE-ik për të plotësuar apo qartësuar çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 e jo dokumentet të cilat nuk janë paraqitur në tender. Ua përkujtoj se në tenderin tuaj lista e paisjeve dhe marrëveshjet për shfrytëzim të tyre përpunohen me dëshmitë e ofruara, por nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT-se. Pretendimi juaj se ngarkimin e të gjitha dokumenteve nuk ua ka lejuar E-prokurimi poashtu është i pa qëndrueshëm pasi që në rastet e tilla edhe nëse paraqiten duhet të kërkonin ndihmë nga Helpdesku i KRPP-se, dhe kur ka konfirmim për

mosfunksionim te platformes duhet anuluar aktivitetin, e qe kjo ne rastin tuaj nuk ka ndodh dhe nuk ka pasë asnjë informatë as nga ju, as nga OE-ik tjerë e as nga KRPP-ja se diçka e tillë ka ekzistuar në kohën e dorëzimit të tenderëve në platformën elektronike.

Bazuar në sqarimet e cekuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit